

VENDIM
Nr.43, datë 11.4.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MUSO HEC QYTEZË” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “a”, dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18, pika 1, germa “a”, dhe nenit 38, të Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.4.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Muso Hec Qytezë” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Qytezë,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Muso Hec Qytezë” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Qytezë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta